



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 shkurt 2020
Nr. ref.:RK 1511/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI71/19

Parashtrues

Avni Vula

Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosnxjerrjes së Ligjit për kthim të pronës dhe Ligjit mbi veprimin me pronën (Fl. Zyrtare JDF nr. 36/45) si dhe ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji (Fl. Zyrtare e RPFJ-së, nr. 64/46)

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Avni Vula (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësim të kushtetutshmërisë së obligimit të shtetit kosovar për: *“Nxjerrjen e Ligjit mbi kthimin e pronave-Restituimin [...] Ligjit mbi veprimin me pronën të cilën pronarët kanë qenë të detyruar ta braktisin gjatë okupimit dhe pronën e cila iu është marrë nga okupatori dhe ndihmësit e tij Fl. Zyrtare e JDF, nr. 36/45”*.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë: (i) së obligimit të shtetit kosovar për nxjerrje të Ligjit për kthim-Restituim të pronës dhe (ii) shpalljen nule dhe të pavlefshme të të gjitha ligjeve, rregulloreve, dekreteve dhe vendimeve gjyqësore lidhur me të drejtat pronësore të ish-Jugosllavisë që nga viti 1945 e deri në ditët e sotme.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 maj 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 maj 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
7. Më 10 maj 2019, parashtruesi i kërkesës solli një dokument shtesë me ç’rast si palë kundërshtare identifikoi Qeverinë e Republikës së Kosovës.
8. Më 29 korrik 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit.
9. Më 15 janar 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se më 30 mars 2015, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionit për Legjislacion të Kuvendit të Kosovës me kërkesë për miratimin e Ligjit për Kthimin-Restituimin e pronave dhe

shpalljen të pavlefshëm të ligjeve, rregulloreve, dekreteve dhe vendimeve diskriminuese të periudhës 9 mars 1945 deri në ditët e sotme.

11. Në vitin 2018, parashtruesi i kërkesës kishte përsëritur kërkesën e tij, edhe dy herë të tjera, ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës, përfshirë edhe Zyrën e Avokatit të Popullit, por nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6. 1 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së.
13. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Nxjerrja e Ligjit mbi kthimin e pronave-Restituimin, ka qenë dhe është OBLIGIM i këtij Shteti jo vetëm me Konventa dhe ligje Evropiane e ndërkombëtare por edhe me Anexin XII-nen. 2- Agjenda legislative me të cilën është caktuar që në periudhën tranzitore (e cila kaheerë ka përfunduar) Shteti i Kosovës OBLIGOHET të miraton edhe këtë ligj në afat prej gjashtë muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Plani”*.
14. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“NULIMI i Ligjeve, Rregulloreve, Dekreteve dhe Vendimeve diskriminues të ish-YU dhe Serbisë të cilat i nxorën që nga dt. 9. 05. 1945 e deri në fundin e regjimit të Aparthejdit në Kosovë është gjithashtu dhe para së gjithash edhe DETYRË jo vetëm nga Plani i Ahtisarit por EDHE OBLIGIM I PASHMANGSHËM I QEVERISË SË KOSOVËS ndaj popullatës së diskriminuar me shekuj të kësaj Kosove”*.
15. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të nxjerrë Aktgjykim duke konstatuar: *“(i) Kërkesa e palës Avni. Q. Vula, nga Prishtina, SHPALLET e pranueshme; (ii) SHPALLET NUL Ligji mbi veprimin me pronën kanë qenë të detyruar ta braktisin gjatë okupimit dhe pronën e cila iu është marrë nga okupatori dhe ndihmesat e tij (Fl. Zyrtare e JDF nr. 36/45) dhe ndryshimet e plotësimet e këtij Ligji (Fl. Zyrtare e RFPJ-së nr. 64/46) si ligj në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe KEDNJ; (iii) SHPALLEN të pavlefshme dhe pa fuqi ligjore aktgjykimet, vendimet gjyqësore dhe aktet tjera juridike e administrative të nxjerra në bazë të dispozitave të këtij ligji; (iv) Gjykata deklaron se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë”*.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
17. Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, që përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

18. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (1) (a) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që specifikon:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) Kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar”.

19. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në thelb ngre dy pretendime: (i) obligimin e institucioneve kosovare për të nxjerrë ligj për kthimin-restituimin e pronave dhe (ii) shpalljen nule dhe të pavlefshme të të gjitha ligjeve, rregulloreve, dekreteve dhe vendimeve gjyqësore lidhur me të drejtat pronësore të ish-Jugosllavisë që nga viti 1945 e deri në ditët e sotme.
20. Duke marrë parasysh natyrën e pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata konsideron se së pari duhet të shqyrtojë nëse kërkesa është dorëzuar në mënyrë ligjore nga pala autorizuar siç përcaktohet me nenin 113.1 të Kushtetutës.
21. Gjykata vëren se bazuar në nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, KEDNJ është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Republikën e Kosovës, kurse bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut duhet të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshmë: GJEDNJ).
22. Gjykata vëren se neni 79 [Nisma Legjislative] i Kushtetutës, përcakton: *“Nismën për të propozuar ligje, mund ta marrë Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimtaria e saj/tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose më së paku dhjetë mijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.*
23. Në këtë drejtim, Gjykata përsërit se Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh *actio popularis*, që do të thotë se individët nuk mund të ankohen në abstrakt ose t'i sfidojnë drejtpërsëdrejti veprimet ose mosveprimet e autoriteteve publike. Kushtetuta e Kosovës ofron mbështetje për individët sa i përket veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike vetëm përbrenda fushëveprimit të përcaktuar me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, që kërkon nga parashtruesit të tregojnë se janë: (1) palë të autorizuar, (2) të prekur drejtpërsëdrejti nga akti konkret ose mosveprimi i autoriteteve publike, dhe (3) se kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. (shih rastin nr. KI39/11, parashtrues *Tomë Krasniqi*, Aktvendim për papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese, i 30 janarit 2013, paragrafi 40 dhe referencat e përmendura aty).
24. Gjykata, gjithashtu i referohet vendimeve kryesore të GJEDNJ-së në të cilat është diskutuar çështja e kthimit të pronës, aplikueshmëria e garancive të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së lidhur me kthimin e pronës, dhe obligimet që Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës (në tekstin e mëtejshmë: Shtetet Kontraktuese) kanë në këtë drejtim (shih, mes autoriteteve tjera, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 4 marsit 2003, *Jantner kundër Sllovakisë*, nr. 39050/97, paragrafi 34; Aktgjykimin e GJEDNJ-së [DHM], të 10 korrikut 2002,

Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke, nr. 39794/98, paragrafët 70-74).

25. Gjykata vëren se në vendimet e lartpërmendura të GJEDNJ-së, në paragrafët specifike të cituar më lart, *inter alia*, thuhet që neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk mund të interpretohet sikur imponon obligime të përgjithshme mbi Shtetet Kontraktuese që të kthejnë pronën e cila iu është transferuar atyre para se të ratifikonin KEDNJ-në. Ky është parimi i parë bazë. Ky nen po ashtu nuk mund të interpretohet ashtu që i njëjti e kufizon lirinë e Shteteve Kontraktuese të përcaktojnë fushëveprimin e kthimit të pronës apo zgjedhjen e kushteve nën të cilat do të bëhet kthimi i pronës tek ish-pronarët. Ky është parimi i dytë bazë (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Jantner kundër Sllovakisë*, cituar më lart, paragrafi 34).
26. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së më tutje tregon që, në veçanti, Shtetet Kontraktuese gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi (*wide margin of appreciation*) në lidhje me përjashtimin e disa kategorive të ish-pronarëve nga një e drejtë e tillë. Aty ku kategoritë e caktuara të pronarëve janë përjashtuar në këtë mënyrë, kërkesat e tyre për kthim nuk mund të konsiderohet se përbëjnë një pritje legjitime (*legitimate expectation*) që vë në lëvizje mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Ky është parimi i tretë i rëndësishëm (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së [DHM], të 10 korrikut 2002, *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, nr. 39794/98, paragrafët 70-74). Në anën tjetër, si parim i katërt bazë, është e rëndësishme të potencohet që, në momentin që një Shtet Kontraktues i cili e ka ratifikuar KEDNJ-në, përfshirë dhe Protokollin nr. 1, e nxjerr një ligj në bazë të të cilit parasheh kthim të tërësishëm apo të pjesshëm të pronës së konfiskuar nga një regjim i kaluar, atëherë legjislacioni i tillë konsiderohet si legjislacion i cili krijon një të drejtë të re pronësie e cila mbrohet, në këtë rast, nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, për të gjithë ata persona të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me atë ligj (shih vendimet e GJEDNJ-së të cituara më lart dhe po ashtu shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI78/18, parashtrues *Pashk Malota*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 prillit 2019, paragrafi 51).
27. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se KEDNJ-ja dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së: (i) nuk i obligon Shtetet Kontraktuese që të nxjerrin një Ligj për kthimin e pronës; (ii) iu lejon Shteteve Kontraktuese liri të konsiderueshme në vendosjen dhe përcaktimin e fushëveprimit të kthimit të pronës dhe zgjedhjen e kushteve të aplikueshme për një gjë të tillë; (iii) iu mundëson Shteteve Kontraktuese të përcaktojnë ose përjashtojnë kategori të caktuara nga e drejta për kthim të pronës; dhe (iv) i obligon Shtetet Kontraktuese që, në rastet kur vet kanë vendosur që të nxjerrin ligj për kthimin e pronës, të respektojnë të drejtën për mbrojtje të pronës të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së meqë në raste të tilla mbrojtja nga ky nen është e drejtë e garantuar me KEDNJ. Këto janë katër parimet e përgjithshme lidhur me çështjen e “kthimit të pronës”, në bazë të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, tashmë të konsoliduar në këtë drejtim (shih, *mutatis mutandis*, rasti nr. KI78/18, parashtrues *Pashk Malota*, cituar më lart, paragrafi 52).
28. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në Republikën e Kosovës nuk ka një ligj të veçantë për kthim të pronave dhe si rrjedhojë kërkesat për kthim të pronave

nuk mund të bazohen në garancitë që i ofron neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së apo, *mutatis mutandis*, në garancitë e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Kjo, siç u shpjegua më lart, për arsyen e vetme që kërkesat për kthim të pronave nuk mund të konsiderohen se përbëjnë një “pritje legjitime” përderisa nuk ekziston një ligj për kthim të pronave (shih rastin nr. KI78/18, parashtrues *Pashk Malota*, cituar më lart, paragrafi 53).

29. Gjykata rikujton se përmendja në formë vetëm nominale të neneve të Kushtetutës dhe KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të konstatuar shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë pretendimet në mënyrë të arsyetuar dhe me argumente bindëse (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI136/14, parashtrues *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
30. Sa i përket pretendimeve për shpallje nule dhe të pavlefshme të ligjeve, rregulloreve, dekreteve dhe vendimeve gjyqësore në lidhje me të drejtat pronësore qysh nga viti 1945 deri në ditët e sotme, Gjykata konsideron se është fakt i ditur botërisht se institucionet e Republikës së Kosovës kanë nxjerrë ligje për plotësimin e organikës ligjore lidhur me të drejtat pronësore por edhe për çështje të tjera që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e individëve në Republikën e Kosovës.
31. Pretendimi i lartpërmendur është konfuz dhe se objektivisht është e pamundur për Gjykatën që t’i kuptojë ankesat e parashtruesit në këtë drejtim.
32. Rrjedhimisht, kërkesa në baza kushtetuese është e papranueshme, për shkak se nuk është dorëzuar në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar siç përcaktohet me nenin 113.1 të Kushtetutës dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit, rregullin 39 (1) (a) Rregullores së punës, më 15 janar 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi